



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

P.nr.325/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunatoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në çështjen penale kundër të pandehurit A... M...nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.796/2023 të datës 16.05.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar dhe publik më datë 26.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit: **A... M...**, me pseudonim "L...", nga babai R... dhe nëna F... e lindur A..., i lindur më dt..... në Gjilan, ku edhe jeton me adresë në rr....., nr.3..., ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i pa martuar, me gjendje të varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më nr. personal. 1..... i dënuar dhe në procedurë edhe për vepra tjera).

Ë S H T Ë F A J T O R S E P S E

Më datë 10.05.2023 rreth orës 20.51h-21.30h, në Gjilan, në rr."H.....", në lokalitetin e kursit të gjuhës gjermane ".....", i pandehuri A... M..., me dashje dhe me qëllim që t'i sjellë vetes apo tjetrit dobi pasurore të kundërligjshme ka përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme pasurinë e të dëmtuarës E.. O..., në atë mënyrë që përderisa e dëmtuara ishte me nxënës duke ligjruar në njërin nga klasat, i pandehuri në mënyrë tinzare hyn në objekt dhe tek recepcioni të dëmtuarës i vjedh telefonin e markës Iphon X dhe portoflin ku e dëmtuara kishte 242 euro dhe dokumentet personale dhe kartelën e bankës, dhe vetëm pas një pune intenzive të policisë i pandehuri identifikohet dhe arrestohet, ku tek i njëjti gjendet telefoni, portofoli, dokumentet personale të dëmtuarës dhe 111.50 € dhe një dollar, ndërsa pjesën tjetër i kishte shpenzuar, me çrast me veprimet e tija të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 130€.

Me çka ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,43,46,49, 69,70,71 dhe 72 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK-së), të pandehurit i shqipton:

DENIM ME GJOBË

Ashtu që i pandehuri A... M...dënohet me dënim me gjobë në shumë prej **200 (dyqind-euro)€**,të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në 3(tri) këste mujore nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë)muajve të cilin është i obliguar që ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarit do ti zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20€(njëzet euro) ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20€ (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

Të pandehurit A... M...-koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 10.05.2023e deri me datë 06.07.2023 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej 20€, si dhe 20 euro per kompenzimin e viktimave te krimi, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan,Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.796/2023 të datës 16.05.2023, ndaj të pandehurit A... M...nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 06.07.2023, i cili është sjellur sipas urdhërersës P.nr. 325/2023 e datës 06.07.2023, pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, është deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale.Ndërsa e dëmtuara E... O... është deklaruar se heq dorë nga ndjekja penale dhe nuk kerkoj kompensim dëmi material.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për kryerjen e veprës penale konform nenit 242 paragrafi 1 i KPRK-së, për të cilin akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se e pandehura nuk ka qenë e detyruar ose e shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se e pandehuri, A... M...nga Gjilani, ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së.në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratës se të pandehurit, e ka shpallur fajtor të pandehurin, i cili ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtës i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtit janë dhe penalisht përgjegjës.Kjo për faktin se i njëjti e ka pranuar edhe vet.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se të pandehurit A... M...duhet ti shqiptohet dënimi me gjobë ne shumen prej 200(dyqindë) euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në 2(dy) këste mujore, duke filluar nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë se këtij aktgjykimi si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8(tetë) muajve të cilin është i obliguar që ta mbaj nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Mirëpo nëse eventualisht i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së të njëjtit,dënimin me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim duke ju llogaritur çdo 20 euro të barabartë me 1 (një) dite burgimi, ose në mënyrë përpjesëtimore me pjesën e dënimit të gjobës së pa paguar, të cilin dënim duhet ta filloj ta mbaj ne afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e pranimit të ftesës nga gjykata.

Me rastin e matjes së dënimit e të pandehurit, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 72 të KPRK-së, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim është fakti se e pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë penale, e se e njëjti i ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale.Ndërsa, rrethanë rënduese gjykata ka marr parasysh veprën e përsëritur penale ngase këtë fakt gjykata e vërtetoi nga dosja te cilën e ka siguruar tek referntat e kësaj gjykate se i pandehuri është recidivist i veprave të ndryshme penale e që të plotëfuqishme janë: P.nr. 394/2013, P.nr.223/2016, P.nr.1271/2016, PKR.nr. 21/2004,P.nr 1108/2016, P.nr.383/2017,P.nr.2028/16,P.n.2930/16,P.nr.1812/16 P.nr.457/2011 P.nr. 1267/2015 etj...

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se dënimi me gjobë ne shumen prej 200(dyqindë)euro dhe dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë)muajve, do të konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7.Vendimi per arrest shtëpiak

Gjykata duke u bazuar në nenin 79 të KPRK-së kohen e kaluar në arrest shtëpiak do t'ia llogarit në dënimin e shqiptuar.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurës, gjykata, duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin t'a detyrojë për t'i paguar shpenzimet e procedurës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.325/2023, më datë 06.07.2023

Bashkpunëtorë Profesionale,
Vlora Selmani-Rahimi

Gjyqtari,
Veli KRYEZIU

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas vlerësimit të mbrojtjes të pandehurit në fjalë dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës mori dhe në prani të Prokurorit të shtetit, dhe të pandehurit, në të njëjtën ditë publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit: **ARSIM MIFTARI**, me pseudonim “Lecka”, nga babai Riza dhe nëna Feride e lindur Aliu, i lindur më dt.23.06.1981 në Gjilan, ku edhe jeton me adresë në rr.”Vëllezërit Llozana”, nr.32, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i pa martuar, me gjendje të varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më nr. personal. 1013054785(i dënuar dhe në procedurë edhe për vepra tjera).

Ë S H T Ë F A J T O R S E P S E

Më datë 10.05.2023 rreth orës 20.51h-21.30h, në Gjilan, në rr.”Haki Muderizi”, në lokalin e kursit të gjuhës gjermane “The Black Board”, i pandehuri A... M..., me dashje dhe me qëllim që t'i sjellë vetes apo tjetrit dobi pasurore të kundërligjshme ka përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme pasurinë e të dëmtuarës Erë Osmani, në atë mënyrë që përderisa e dëmtuara ishte me nxënës duke ligjëruar në njërin nga klasat, i pandehuri në mënyrë tinzare hyn në objekt dhe tek recepcioni të dëmtuarës i vjedh telefonin e markës Iphon X dhe portoflin ku e dëmtuara kishte 242 euro dhe dokumentet personale dhe kartelën e bankës , dhe vetëm pas një pune intenzive të policisë i pandehuri identifikohet dhe arrestohet, ku tek i njëjti gjendet telefoni, portofoli , dokumentet personale të dëmtuarës dhe 111.50 € dhe një dollar, ndërsa pjesën tjetër i kishte shpenzuar , me çrast me veprimet e tija të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 130€.

Me çka ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së,

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,43,46,49, 69,70,71 dhe 72 të KPRK, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale (KPPK-së), të pandehurit i shqipton:

D E N I M M E G J O B Ë

Ashtu që i pandehuri A... M...dënohet me dënim me gjobë në shumë prej **200 (dyqind-euro) €**, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në 3(tri) këste mujore nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë)muajve të cilin është i obliguar që ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë atëherë dënimi me gjobë me pajtimin me të akuzuarit do të zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20€(njëzet euro) ndërsa nëse i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20€ (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë shumën prej 20€, si dhe 20 euro per kompenzimin e viktimave te krimin, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V ë r t e t o j n ë

Zyrtarja Ligjore,

G j y k a t ë s i